

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE”

Raporti Përfundimtar i Auditimit, të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale” me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësimin e zbatimit të projektit për periudhën nga 01.07.2010 deri më 31.03.2012” dhe masat për përmirësimin e gjendjes , janë ratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.463/7, datë 26/07/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.463/8, datë 26/07/2012 dërguar [REDAKTUAR], Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Të merren masa nga FSHZH, për zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga dy auditimet e mëparshme për projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale” .

“Menjëherë”

2. Të merren masa nga FSHZH, pasi kontratat janë në proces apo periudhë garancie defektsh, për të riparuar plasaritjet në shtresat e asfaltit, si dhe të mureve të betonit, ku rezultatet e testeve nuk plotësojnë standardet teknike, bazuar në kushtet e kontratës së zbatimit.

“Menjëherë”

3. Të merren masa nga Njësia e Prokurimit, që për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillohet nga FSHZH në kuadër të realizimit të projektit “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”, përlllogaritja e përcaktimit të vlerës së kontratës të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

“Në vazhdimësi”

4. Të merren masa nga Njësia e Prokurimit, që në dosjet e procedurave për tenderat që do të zhvillohen në të ardhmen, për projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”, dokumentet e blerjes dhe tërheqjes së dokumenteve të tenderit nga operatorët ekonomik, të jenë pjesë e inventarit të dosjes.

“Në vazhdimësi”

5. Të merren masa nga Njësia e Prokurimit, që për procedurat e tenderit që do të zhvillohen në të ardhmen, për projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”, para zhvillimit të procedurës, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratë për paanësi dhe konflikt interesi, në lidhje me objektin e tenderit.

“Në vazhdimësi”

6. Të merren masa që në të ardhmen për të gjitha zbatimet e kontratave me objekt blerje mallrash, për projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”, që marrja në dorëzim

e mallrave të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat, kriteret e kërkuar, specifikimet dhe dokumentet, në përputhje me kontratat e lidhura.

“Në vazhdimësi”

7. Të merren masa nga Këshilli Ekzekutiv i FSHZH, për rishikimin e vendimit nr. 31, datë 23.11.2007 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 23, datë 03.05.2004, të Komitetit Ekzekutiv për përcaktimin e masës së rimbursimit të shpenzimeve, për dietat dhe udhëtimet brenda vendit”, referuar VKM në fuqi për këtë qëllim.

“Menjëherë”

8. Të merren masa nga FSHZH, për kalimin sa më shpejt të inventarit të segmenteve të rrugëve të përfunduara e marra në dorëzim, pranë Autoritetit Rrugor shqiptar, në përputhje me VKM nr. 184, datë 13.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 405, datë 08.01.1996 “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural”.

“Në vazhdimësi”

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **234, 960 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese [REDACTED] dhe [REDACTED], për punime të pakryera.

“Menjëherë”

2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **1,410,579 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese [REDACTED] dhe [REDACTED], për punime të pakryera.

“Menjëherë”

3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **1,920,600 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese [REDACTED] dhe [REDACTED], për punime të pakryera.

“Menjëherë”

4. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **1,020,789 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese [REDACTED], për punime të pakryera.

“Menjëherë”

5. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **1,448,401 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e

gjkimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria zbatuese [REDACTED] dhe [REDACTED], për punime të pakryera.

“Menjëherë”

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi, Yllka Pulashi, Nikolin Gjonaj dhe Mimoza Bedini më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiri, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.